

**VENDIM**  
**Nr. 1059, datë 21.10.2009**

**PËR LEJIMIN E ZHVILLIMIT TË PROCEDURAVE TË DISA PROKURIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të nenit 9 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009” dhe të pikës 3 të vendimit nr.787, datë 22.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një përdorim me efektivitet të fondeve për investime”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve, që, brenda datës 15 dhjetor 2009, të realizojë procedurat e prokurimit, për objektet e përcaktuara në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi (katër objekte). Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Tabela 1

| <b>Nr</b> | <b>Objekti i prokurimit</b>                                                                                 | <b>Autoriteti kontraktor</b>                        |
|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| 1         | Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të ujësjiellës për zonat e plazhit Durrës-Kavajë nga pusshpimet e Rrogozhinës | Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve |
| 2         | Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza Sarandë, derdhja në IPUZ                                   | Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve |
| 3         | Ndërtimi i rrjetit të ujësjiellës Përroi i Agait-Plepa, Durrës.                                             | Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve |
| 4         | Studim projektim për furnizimin me ujë të zonës së Dumresë, Elbasan.                                        | Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve |